



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

NJOFTIM

Në mbledhjen e datës 21 maj 2026, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe diskutimeve të zhvilluara në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, mori vendimet që vijojnë:

U vendos fillimi i procedurës për një ndryshim në vendimin e bordit të ERE-s nr. 139, datë 14.04.2023, “Mbi miratimin e kufijve minimalë dhe maksimalë të lejuar të çmimit për tregun e ditës në avancë”.

U miratua kërkesa e shoqërisë “HYDROSOLAR ENERGY (HSE)” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

U vendos fillimi i procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “5GX ENERGY” sh.p.k. për modifikimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me kapacitet të instaluar 10 MW.

U refuzua kërkesa për pezullimin e licencës për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “VOKOPOLA ENERGJI” sh.p.k., me vendimin e bordit të ERE-s nr. 161, datë 17.06.2022.

U miratuan disa ndryshime në vendimin e bordit të ERE-s nr. 207, datë 09.09.2025, “Mbi licencimin e shoqërisë “AMEL ENERGY” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik, me kapacitet prodhues 2 MW”.

U miratuan disa ndryshime në vendimin e bordit të ERE-s nr. 40, datë 14.02.2025, “Mbi licencimin e shoqërisë “EB ENERGY” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”, i ndryshuar.

U miratuan disa ndryshime në vendimin e bordit të ERE-s nr. 41, datë 14.02.2025, “Mbi licencimin e shoqërisë “GREEN PLUS ENERGY” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”, i ndryshuar.

U vendos përfundimi i procedurës lidhur me kërkesën e shoqërisë “EZ-5 ENERGY” sh.p.k. për marrjen e autorizimit të ERE-s për transferimin (nëpërmjet barrësimit) të asetëve të paluajtshme të saj, si mjet për garantimin e përmbushjes së detyrimit ndaj “Raiffeisen Bank” sh.a.

U miratua kërkesa e shoqërisë “NRG POWER” sh.p.k. për marrjen e autorizimit të ERE-s për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e saj.

Vendimet e plota publikohen në faqen zyrtare të ERE-s dhe në Fletoren Zyrtare.